



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:248736
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483099

PPP.nr.225/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit D.e.K., me seli në Prishtinë, lagjja ..., rr "...", kundër debitorit I.D.T. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit I.T., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.382/2022, i datës 07.11.2022, i lëshuar nga përmbareuesi privat Sh.L. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.382/2022, i datës 07.11.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.382/2022, të datës 07.11.2022, përmbareuesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga kreditori D.e.K., kundër debitorit I.T., për pagesën e borxhit në shumë prej 7,265.00 euro dhe shpenzimet e përmbaremit, në bazë të aktgjykimit C.nr.886/20, të datës 23.10.2020, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbareuesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarrim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarrim P.nr.382/2022, i datës 07.11.2022.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se: me propozimin e atakuar përmbarruesi privat ka shkelur dispozita ligjore të nenit 34,35,341 dhe neni 360 të LMD-së, në nenin 34, al 2, të LMD-së është parashikuar që detyrimi duhet të jetë i mundshëm i lejuar dhe i caktueshëm, në rastin konkret përmbarrimi nuk është i mundshëm për faktin se debitori nuk e ka dëmtuar buxhetin e Kosovës për shkak se i njëjti për automjetet të cilat paditësja mendon se nuk është paguar Dogana nga debitori nuk qëndron për shkak se të dëmtuar me veprimet e debitorit fillimisht kanë qenë personat fizik dhe jo D.e.K. si kreditore në këtë procedurë për arsye se debitori të gjithë personave fizik të cilët ishin të dëmtuar që figurojnë në aktgjykimin P.nr.531/08, 552/08, të datës 05.11.2008, të Gjykatës Komunale në Ferizaj janë kompensuar nga debitori kështu që kreditorja nuk është dëmtuar fare. Në rastin konkret kreditorja kërkon kompensim të dyfishtë për automjetet të cilat kanë qenë objekt i veprës penale të kryer nga debitori, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse në rastin konkret siç vërtetohet nga shkresat e lëndës, Përmbarruesi Privat Sh.L. e ka nxjerrë urdhrin e atakuar me prapësim në bazë të aktgjykimit C.nr.886/20, të datës 23.10.2020, i cili në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, konsiderohet dokument përmbarrimor në bazë të cilit mund të caktohet përmbarrimi dhe meqenëse aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbarrim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, atëherë edhe ekzekutimi i aktgjykimit në fjalë është i mundshëm dhe i lejuar. Për më tepër, Gjykata konsideron se gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim, nuk mund të bëjë hetim të fakteve apo vërtetim tjetër të gjendjes faktike nga ajo e cila është bërë me nxjerrjen e aktgjykimit C.nr.886/20, të datës 23.10.2020, përveç vlerësimit të ligjshmërisë së nxjerrjes së urdhrin për përmbarrim, të cilin gjykata e konsideron si të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se aktgjykimi C.nr.886/20, i datës 23.10.2020, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarrim, e përmban edhe klauzolën e përmbarrueshmërisë për

përmbareshmëri, respektivisht është i plotfuqishëm nga data 05.04.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 25.08.2022 dhe kështu i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 36, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata konstatoj se propozimi për përmbaram i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përmbaram i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përmbaram, dokumentin përmbaramor në origjinal, kërkesin e përmbaramit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbaramit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjykata konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbaram P.nr.382/2022, i datës 07.11.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.225/22, më datë 21.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij akt